



Sfidat dhe mundësitë për rritjen e angazhimit të të rinjve në procesin e integritimit në BE në Shqipëri

DOKUMENT PUNE 1/2019

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim - Qershor 2019

Nga Dafina Peci

Projekti "Një qasje sektoriale për kontributin e shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian" - CONNECT, zbatohet në partneritet me:



Politikat Rinore në Shqipëri

Pjesëmarrja e të rinjve në proceset politikëbërëse në Shqipëri në përgjithësi është e ulët dhe kjo ka ardhur për shkak të shumë faktorëve, siç është mungesa e hapësirave nxitëse për përfshirjen e të rinjve, mungesa e informimit dhe edukimit qytetar të të rinjve për të qenë aktiv në komunitet dhe më gjerë, apo dhe mosekzistenca e një mekanizmi politik që bën bashkë të rinjtë me institucionet.

Megjithatë, strategjitë dhe planet kryesore për përfshirjen sociale dhe ekonomike të të rinjve në Shqipëri janë influencuar nga politikat dhe kuadri European, ku më të rëndësishmet në nivel kombëtar dhe lokal janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 (SKZHI);
- Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2013-2020;
- Strategjia e mbrojtjes sociale 2015-2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020;
- Plani Kombëtar Veprimi 2010-2015 për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianë (brenda SKZHI) - i krijuar mbi Planin Kombëtar të Veprimit

2010-2015 - Dekada e përfshirjes së Romëve;

- Ligji mbi “Barazinë gjinore në shoqëri” (i aprovuar në 2008) dhe i amenduar i cili u prezantua në 2012;
- Ligji për Rininë i cili synon plotësimin e kuadrit ligjor ekzistues që ndikon tek të rinjtë, si edhe rritjen e pjesëmarrjes të të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse;
- Planet Vendore të Veprimit për të Rinjtë në 13 Bashki të Shqipërisë, për periudhën kohore 2020-2023.

1. Impakti i politikave rinore në pjesëmarrjen e të rinjve në procese politikëbërëse dhe vendimmarrëse

Pjesëmarrja rinore është një proces vullnetar, përmes të cilit të rinjtë ndikojnë në vendimmarrje dhe kontribuojnë në zbatimin e politikave publike. Pjesëmarrja politike dhe qytetaria aktive janë elementë thelbësorë të një kulture politike demokratike në çdo shoqëri. Duhet pasur parasysh që rinia, si një grup specifik shoqëror, ka kërkesa specifike që duhet të trajtohen në mënyrë të mëvetësishme në procesin e hartimit të politikave.

Të rinjtë nën moshën 30 vjeç përfaqësojnë një të tretën e popullsisë në Shqipëri, dhe sipas parimeve të demokracisë do duhet të përfaqësonin edhe 1/3 e klasës apo vendimmarrjes politike në vend. Rinia shqiptare në raport me politikën dhe partitë shpesh është përballur me sfida nga më të ndryshmet. Partitë politike shpesh e shmangin ose e paraqesin si shtojcë në programet e tyre çështjen e rinisë, madje edhe kur përmendin punësimin e tyre si objektiv të fushatës, ato i referohen numrave të të punësuarve dhe jo se si do të krijohen vendet e punës, në cilët sektorë, etj.

Nga ana tjetër, forumet rinore politike nuk kanë qenë të përfaqësuara nëpërmjet karrierës së brendshme në pozicione ekzekutive në qeveri, por nëpërmjet lidhjeve me liderin e partisë dhe konjukturave të brendshme. Edhe disa të rinj nën 30 vjeç që vitet e fundit kanë mbajtur rolin e ministrit, zëvendësministrit, deputetit apo kryetarit të bashkisë, nuk kanë rezultuar produkt i forumeve rinore, por i konjunkturave të brendshme dhe vendimeve të kryetarëve të partive të mëdha në vend.

Në terma vendimmarrjeje në nivel lokal, vihet re se ka një diferencë të theksuar moshe mes kandidatëve dhe të

përzgjedhurve në moshë të re. Ky fenomen ndodh sepse të rinjtë vendosen në fund të listave të kandidimit që partitë politike dërgojnë në KQZ, gjë që ul shanset e përzgjedhjes së tyre. Në zgjedhjet vendore të vitit 2015 vetëm 4.91% (3 nga 61) kryetarë bashkie ishin nën moshën 30 vjeç.

Ky hendek mes të rinjve dhe përfaqësimit të tyre në qeverisje, programeve elektorale dhe vendimmarrjes ka ulur interesin e të rinjve shqiptarë për politikën. Kjo vihet re edhe në studimin e fundit të publikuar nga Fondacioni Friedrich Ebert “Rinia Shqiptare 2018/2019”, sipas të cilit 62% e të rinjve pohojnë se nuk janë fare të interesuar për politikën, ndërsa 31% e të intervistuarve thonë se nuk janë aspak të përfaqësuar në politikë.¹

Pjesëmarrja e të rinjve në nivel lokal si në aspektin politik, kulturor, ashtu edhe atë socio-ekonomik mbetet ende e ulët. Një hendek i madh mbetet ai midis të rinjve që jetojnë në qendrën e qytetit dhe atyre që jetojnë në periferi ose zonat rurale. Përsa i përket infrastrukturës, aksesit në shërbime dhe të ardhura, deri në vitin 2015, INSTAT deklaroi se 32, 8% e të rinjve nuk janë pjesë

¹ Rinia Shqiptare 2018/2019, Studim, Zyra e Fondacionit Friedrich Ebert Tiranë, 2019. Publikimi

mund të lexohet këtu: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf>

e tregut të punës, arsimit apo trajnimeve të ndryshme profesionale.²

Lidhur me pjesëmarrjen politike në nivel lokal, sipas një raporti të kryer nga Youth Balkan Hub mbi pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve në Shqipëri, numri i të rinjve në pozicionet drejtuese është i ulët. Në terma vendimarrje vetëm 4.91% (3 nga 61) kryetarë bashkie janë nën 30 vjeç.³ Përsa i përket strukturave rinore nëpër bashki, ato nuk janë ngritur ende dhe rrjedhimisht sjellin një numër të ulët të të rinjve në vendimarrje. Institucionet lokale kanë mungesë të theksuar në raport me ndërveprimin me publikun dhe sidomos me të rinjtë.

Duke qenë se të rinjtë përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë në vend, ata kanë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të vendit dhe zgjidhjes së shumë problematikave lidhur me jetën sociale, kulturore dhe ekonomike të tyre.

Përfshirja e minoriteteve gjithashtu mbetet një sfidë, pasi numri i të rinjve kryesisht nga komunitet Rome dhe Egjyptiane, kanë nivel të ulët arsimor dhe për pasojë përjashtohen

nga mundësia për të qenë pjesë aktive në komunitet, apo pjesë e trajnimeve të ndryshme.

Përsa i përket pjesëmarrjes së të rinjve në fusha të ndryshme, dhe sidomos sferës politike, duhet punuar në rradhë të parë me kuadrin ligjor dhe institucional në mënyrë që të garantohet një përfshirje më cilësore dhe efektive rinore.

Rekomandime:

Duke marrë në konsideratë këto të dhëna mbi mungesën e theksuar të përfshirjes së të rinjve në politikëbërje, ekipi i projektit Connect rekomandon ndërmarrjen e hapave të mëposhtme:

- Rritjen e buxhetit për sektorin e rinisë në nivel qendror dhe reflektimi në nivel lokal;
- Ngritjen e drejtorive apo departamenteve të dedikuara për rininë në institucionin e bashkisë;
- Ndërtimin e strategjive / planeve strategjike të dedikuara për rininë në nivel bashkie dhe me rreze veprimi në zonat

² Tregu i Punës, INSTAT 2015. Publikimi mund të lexohet në lidhjen: http://www.instat.gov.al/media/1703/tregu_i_punes_2015_.pdf

³ “The Europe-Western Balkans Youth Meeting “Connecting Youth Work and Youth Policy”,

SALTO-YOUTH 2016. Publikimi mund të lexohet në lidhjen: <https://www.salto-youth.net/downloads/4-17-3471/Report%20Europe-WB%20Youth%20Meeting.pdf>

rurale/ njësitë administrative pjesë të bashkisë;

- Parashikimin e një fondi të dedikuar për organzatat rinore dhe nismat rinore pranë AMSHC-së apo çdo entiteti që synon dhënien e granteve për shoqërinë civile nëpërmjet fondeve publike;

- Hapjen e qendrave rinore në 61 bashki;

- Ngritjen e kapaciteteve të qeverive të nxënësve dhe këshillave studentorë me synim rritjen e performancës së tyre brenda institucioneve arsimore;

- Vënien në zbatim e strategjisë për përdorimin e shkollave si qendra komunitare dhe angazhimi i të rinjve si lehtësues / menaxhues të aktiviteteve që organizohen;

- Nxitjen e takimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta midis të rinjve dhe administratës publike për ndërtimin e besimit dhe nxitjen e transparencës;

- Rritjen e ndërgjegjësimit mbi të mirat e dixhitalizimit dhe ngritje e kapaciteteve të të rinjve për mirëpërdorimin e burimeve dhe akseseseve.

2. Impakti i politikave arsimore në punësimin e të rinjve

Sipas INSTAT, grupmosha e të rinjve 15-29 vjeç përbën 50.1% të forcës totale të punës në Shqipëri. Pavarësisht kësaj, edhe pse të rinjtë përfaqësojnë shumicën e fuqisë punëtore, shkalla e papunësisë është ende shumë e lartë, ku shkalla e papunësisë për 15 - 29 vjeç është 23.1%. Sipas Raportit Rajonal “Ballkani Perëndimor përmes këndvështrimit të të rinjve”, kur pyeten për arsyet përse të rinjtë sot janë të papunë, 31% e të rinjve shprehen se ka kërkesë të ulët të punës që vjen nga sektori publik dhe privat.⁴

Për më tepër, konsultimet e këtij studimi nxorën në pah çështjen e përqendrimit të mundësive të punës në Tiranë ose në qytete të tjera të mëdha. Kjo ka sjellë më pak mundësi punësimi për të rinjtë që jetojnë në zonat rurale. 23% e të anketuarve në këtë studim, vlerësojnë politikën e punësimit të të rinjve si jo-funksionale dhe shprehen jo të kënaqur me masat e marra nga qeveria për të adresuar sfidat e papunësisë së të rinjve.

Mangësitë e politikave kanë shkaktuar një mospërputhje midis aftësive të fituara përmes sistemit të arsimit dhe aftësive të

⁴ “Western Balkans through Youth Lenses,” Western Balkans Youth Cooperation Platform (WBYP) 2019. Publikimi mund të lexohet në lidhjen: <http://www.connecting->

[youth.org/documents/2019_WBYCP%20Policy%20Brief_web.pdf](http://www.connecting-youth.org/documents/2019_WBYCP%20Policy%20Brief_web.pdf)

kërkuara në tregun e punës. 11% e të rinjve theksuan se të rinjtë nuk kanë aftësitë e duhura për të gjetur një vend pune dhe 19% mendojnë se kjo vjen për shkak të mungesës së koordinimit midis sistemit arsimor dhe tregut të punës.

Sot, boshllëqet e konsiderueshme në pjesëmarrjen në tregun e punës dhe tranzicioni shkollë - punë nuk janë adresuar në mënyrë adekuate. Shkalla e papunësisë së të rinjve në Shqipëri është ndër më të lartat në Evropë.⁵ Ndërkohë, përqindja e të rinjve në kategorinë e njohur si NEET (të cilët nuk janë në arsim, punësim ose trajnim) po rritet. Të rinjtë dhe të diplomuarit e fundit nuk janë integruar mirë në tregun e punës dhe niveli i tyre i punësimit është ende nën nivelin potencial të rajonit.

Pasojat e papunësisë së të rinjve rezultojnë në tendencën në rritje të fenomenit të ikjes së trurit, duke përfshirë të rinjtë me aftësi të veçanta. Nisur nga tendencat negative demografike, ai rrezikon mungesën e krahut të punës në të ardhmen. Prandaj, vetëm nëse politikat e synuara nuk ndërmerren urgjentisht, funksionimi i duhur i sektorit publik dhe ofrimi i shërbimeve do të vihet në rrezik. Papunësia shumë e lartë tek të rinjtë e moshës 18-24 vjeç (33% në 2018),

përfshirë të diplomuarit në universitete, tregon për një problem në përafrimin e sistemit të arsimit dhe aftësimin me nevojat e tregut të punës dhe një mjedis të dobët biznesi akoma ende të nën zhvilluar. Në përgjithësi, të rinjtë duket se nuk kanë aftësi të nevojshme për të gjetur punë. Mos përputhja e aftësive gjithashtu pengon një zgjerim më të qëndrueshëm të tregut të punës. Rezultatet e testit PISA 2018 për Shqipërinë ishin shumë më poshtë se mesatarja e OECD. Ato tregojnë se një pjesë e madhe e të rinjve nuk kanë aftësitë themelore për të hyrë në tregun e punës, përveç arsyeve të tjera të tilla si lëvizshmëri e ulët, paga jo tërheqëse dhe kushtet e punës.

Kur bëhet fjalë për tendencat e reja dhe politikat e orientuara drejt rritjes së punësimit të të rinjve, fillestarët e rinj dhe sipërmarrësit përballen me telashe për shkak të procedurave të ndërlikuara dhe rregulloreve jo të harmonizuara. Masat aktive si heqja e tarifave të shumta do të mbështesin sipërmarrësit e rinj për të filluar biznesin e tyre.

Nga ana tjetër, të rinjtë e punësuar shprehen se janë të diskriminuar për shkak të moshës së tyre dhe janë të të

⁵ "Të Rinjtë në Shqipëri, sfidat në kohët që jetojnë", INSTAT, Tiranë, Nëntor 2015.
<http://www.instat.gov.al/>

mbingarkuar me përgjegjësi. Sipas tyre, punëdhënësit nuk investojnë sa duhet në ndërtimin e kapaciteteve të stafit dhe nuk ka programe të dedikuara për trajnimin e punonjësve të rinj.

Rekomandime:

Në kuadër të këtyre të dhënave mbi nivelin e papunësisë së të rinjve në Shqipëri, ekipi i projektit CONNECT rekomandon ndërmarrjen e hapave të mëposhtme:

- Realizimin e një studimi mbi tregun e punës duke krijuar një panoramë të qartë të nevojave reale që kërkon tregu;
- Ndërtimin e sistemit të praktikave duke filluar që në sistemin e arsimit të mesëm;
- Orientimin e politikave të punësimit drejt sektorëve prioritarë të ekonomisë edhe me potencial punësimi si turizmi, agroturizmi, prodhimi si edhe bujqësia në aspektin kombëtar, si edhe harmonizimi me nevojat e tregut ku Shqipëria është lokalizuar;
- Orientimin e mbështetjes drejt financimit të projekteve që premtojnë *job-creation* si një mundësi për motivimin e të rinjëve për të qëndruar në Shqipëri.

3. Politikat Rinore në lentet e Kapitujve të Integritit Evropian: Kapitulli 19 (Politikat Sociale dhe Punësimi) dhe Kapitulli 26 (Edukimi dhe Kultura)

Nga konsultimet lokale të mbajtura nga ekipi i projektit CONNECT “Një qasje sektoriale për kontributin e shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian” në tre qytete të Shqipërisë (Korçë, Vlorë dhe Shkodër), dolën disa sfida sa i takon një angazhimi kuptimplotë të qytetarëve dhe të rinjve në procesin e integritit të Shqipërisë në BE. Shumë prej tyre i referohen mungesës së informacionit që qytetarët dhe veçanërisht të rinjtë në nivelin lokal kanë në lidhje me procesin e integritit dhe anëtarësimit në BE, ndërkohë që përfshirja e tyre në reformat e brendshme dhe në politikëbërje mbetet e ulët.

Për të ofruar një panoramë krahasuese mbi politikat e mundshme për këtë sfidë lokale, shkëmbimi i përvojave me vendet e tjera të rajonit pararendës në procesin e integritit Evropian mund të ketë një vlerë të shtuar. Përvoja e Serbisë me negociatat e anëtarësimit, veçanërisht me kapitullin tashmë të mbyllur 26 "Edukimi dhe Kultura", dhe mbi rolin e rinisë serbe dhe shoqërisë civile gjatë procesit të negociatave, mund të plotësojë perspektivën e brendshme me informacion dhe qasje të reja në adresimin e nevojave të identifikuar në nivel lokal.

Në tryezen e rrumbullakët të organizuar në kuadër të projektit CONNECT në dt. 31 Maj 2019, ish- Kryenegociatorja Serbe për Anëtarësimin e Republikës së Serbisë në BE Prof. Dr. Tanja Mišćević, theksoi se shoqëria civile - dhe rinia në veçanti kanë një rol të rëndësishëm në procesin e integritit dhe anëtarësimin në BE, sidomos në disa kapituj. Prof. Dr. Mišćević theksoi se decentralizimi i politikës rimore në Serbi mund të quhet me plot gojë një arritje e madhe dhe mund të shërbejë si një shembull i mirë për vendet e tjera në rajon, përfshirë këtu edhe vendin tonë.

Kapitulli 19 - Politikat Sociale dhe Punësimi

Rregullat e BE-së në fushën sociale përfshijnë standardet minimale për ligjin e punës, barazinë, shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe mosdiskriminimin.⁶ Në këtë kuadër, sipas progress raporteve të BE-së, Shqipëria duket që ka një nivel të përgatitjes për politikën sociale dhe punësimin. Sipas progres raportit të Komisionit Evropian për vitin 2019, disa përparime janë bërë në rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe në cilësinë dhe efektivitetin e institucioneve dhe shërbimet e tregut të punës, si dhe në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të

Punësimin dhe Aftësive (NESS) për 2014-2020.⁷ Shqipëria ka filluar ristrukturimin e segmentit të punësimin fillimisht nëpërmjet rishikimit të ligjit të arsimit të lartë dhe re-dimensionimit të arsimit profesional (AAP). Statistikat e punësimin dhe të zhvillimit të kapitalit njerëzor janë përmirësuar nga viti paraprak.

Në shkurt 2017, VET u rishikua dhe Ligji u miratua, por aktet nënligjore të tij ende nuk janë miratuar. Asnjë përparim nuk është bërë për zgjerimin e punësimin dhe shërbimeve të AFP-së në zonat rurale. Përpjekje të rëndësishme duhen bërë për të miratuar Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, e cila është një ndër hapat më të rëndësishëm për të përcaktuar arsimin në të ardhmen. Gjithashtu, është e rëndësishme që Korniza Shqiptare e Kualifikimeve të jetë në linjë të plotë me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, në mënyrë që sistemi i arsimit në Shqipëri, të jetë i krahasueshëm me sistemin e arsimit në Evropë, duke përfshirë këtu edhe njohjen e diplomave shqiptare në vendet e BE-së.

Shkalla e punësimin dhe pjesëmarrja e tregut të punës mbetet e ulët, dhe ekonomia informale është ende një ofrues i

⁶ Komisioni Evropian, Politikat e Fqinjësisë Evropiane dhe Negociatat e Zgjerimit, Kapitujt e acquis. Për më shumë lexo: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en

⁷ Komisioni Evropian (2019), *Raporti për Shqipërinë*, COM(2019) 260, Bruksel, 29 Maj. Raporti mund të lexohet në lidhjen: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

rëndësishëm i punës.⁸ Ndaj, në kuadër të këtyre të dhënave lidhur me punësimin dhe pjesëmarrjen në tregun e punës është e nevojshme marrja në konsideratë e rekomandimeve të mëposhtme të kryera nga ekipi i projektit CONNECT, sipas të cilave sfidat kryesore me të cilat përballet Shqipëria janë:

- të sigurojë kapacitete dhe burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të siguruar zbatimin e politikave sociale dhe të punësimit;
- të zhvillojë një qasje strategjike për të trajtuar ekonominë joformale dhe punën e padëklaruar;
- të intensifikojë përpjekjet për të zbatuar strategjinë e mbrojtjes sociale 2015-2020, edhe përmes progresit të mëtejshëm në reformën e kujdesit social dhe lidhjet me masat aktive të punës dhe forcimin e rolit të qeverisjes vendore në zbatim.

Kapitulli 26 - Edukimi dhe Kultura

Në lidhje me fushën e edukimit dhe kulturës, është e nevojshme marrja në konsideratë e rekomandimeve të mëposhtme të kryera nga ekipi i projektit CONNECT, ku Shqipëria duhet në veçanti:

- të sigurojë hartimin e strategjisë së arsimit parauniversitar dhe reformën e arsimit të lartë e cila është implementuar dhe të përmirësojë më tej trajnimin e mësuesve;
- të sigurojë se Ligji i AAP është zbatuar plotësisht, duke përfshirë dhe rishikimin / zgjerimin e sistemit aktual të financimit për AFP;
- të miratojë dhe zbatojë strategjinë kombëtare për kulturën për 2018-2022 për të ruajtur trashëgiminë kulturore Shqiptare.

Sipas raportit të Komisionit Evropian për vitin 2019, në fushën e arsimit dhe trajnimit është bërë progres në miratimin e kurrikulës dhe kornizave legislative. Progres i moderuar është bërë gjithashtu edhe në zbatimin e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, ndërsa aktet nënligjore të mbetura, pritet që akoma të miratohen. Gjithashtu, janë ndërmarrë disa hapa për zbatimin e planit të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020; megjithatë është ende në një fazë shumë të hershme, sidomos lidhur me trajnimin e mësuesve dhe shpërndarjen e kornizës së re kurrikulare. Për arsimin, punimet e infrastrukturës janë në vazhdim, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të

⁸ Për më shumë shiko: <http://www.instat.gov.al/>

përmirësuar infrastrukturën në qytete të vogla dhe zona rurale.

Pjesëmarrja në programin Erasmus+ është përmirësuar më tej, veçanërisht në rritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë, ku dy institucione shqiptare të arsimit të lartë morën pjesë si koordinatorë të projektit për herë të parë dhe në veprimin ndërkombëtar të mobilitetit të krediteve, ku 1,193 mobilitete u dhanë vitin e kaluar, që paraqet një rritje prej +11.5% në raport me vitin e kaluar dhe më shumë se 3,400 që nga fillimi i thirrjes së parë në 2015.

Prioritet i qeverisë për të rinjtë vazhdon të jetë promovimi dhe punësimi i të rinjve. Gjashtë Qendra Rinore janë themeluar në dy vitet e fundit: tre në Tiranë dhe tre të tjera jashtë kryeqytetit.

Sa i përket sektorit të kulturës, Strategjia Kombëtare e Kulturës për 2018-2022 është ende në fazën e hartimit. Projektligji për trashëgiminë kulturore u miratua nga Këshilli i Ministrave në vitin 2017. Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të ngjashme ka hyrë në fuqi në Tetor 2016. Në linjë me Konventën 2005 të UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjes Kulturore dhe është miratuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

4. Dimensioi rinor dhe rajonal

Projekti CONNECT është fokusuar gjithashtu edhe në nxitjen e një debati me palët e interesuara në Shqipëri mbi gjendjen dhe ecurinë aktuale të zbatimit të Plani Shumë-Vjeçar i Veprimit të Zonës Ekonomike Rajonale (*MAP REA*), me një fokus të veçantë në lëvizshmërinë dhe shtyllën dixhitale, në hartëzimin e potencialit ekonomik, inovativ dhe shkencor në vend, në politikat publike përkatëse që kanë një fokus të veçantë në inovacionin, lëvizshmërinë e të rinjve dhe akademikëve dhe punësimin.

Në tryezën e rumbullakët “Sfidat dhe mundësitë për rritjen e angazhimit të të rinjve në procesin e integritimit në BE në Shqipëri,” mbajtur në dt. 31 Maj 2019, Znj. Odeta Barbullushi, Koordinatore Kombëtare për Zonën Ekonomike Rajonale, nënvizoi nevojën për zhvillimin e një strategjie kombëtare që adreson nevojën urgjente për investimin në aftësitë dixhitale të të rinjve me anë të një buxheti të mirëfilltë, i cili është i nevojshëm për të siguruar implementimin e kësaj strategjie.

Me rëndësi dhe prioritet për shoqërinë shqiptare mbetet përcaktimi i një vizioni dhe programi të qartë për zhvillimin socio-ekonomik të vendit bazuar edhe në fushat si dixhitalizimi, inovacioni, lëvizshmëria etj, si

dhe integrimin në tregjet rajonale nën MAP
REA.

Sfida në këtë rrugëtim mbeten kapacitetet e
ulta administrative, mungesa e një
legjislacioni kombëtar në këto fusha, një
ndarje mes REA MAP dhe e Procesit të
Berlinit nga perspektiva e zgjerimit, burime
të limituara financiare, etj.

Referenca:

“Discussing global issues: what is participation?” UNICEF, Mbretëria e Bashkuar, 2004, faq.1.

“Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 dhe Plani i Veprimit” miratuar me VKM Nr. 818, Datë 26 Nëntor 2014.

A. Walther & A. Pohl, IRIS EV, (Oct. 2005), “Thematic Study on Policy Measures concerning Disadvantaged Youth”.

CDI & FES Tirana (2015), “Youth Employment Trends in Albania: What is the Market Looking For?” Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Tiranë 2015. Publikimi mund të lexohet në lidhjen: <http://cdinstitute.eu/web/wp-content/uploads/2016/05/t-150427-text-engl.pdf>

Fondacionit Friedrich Ebert Tiranë (2019). “*Rinia Shqiptare 2018/2019.*” Studim, Tiranë, 2019. Publikimi mund të lexohet në lidhjen: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf>

Hackaj A., Madhi G. and Hackaj K., “*Monitoring the Berlin Process: From Paris to Trieste*”, Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Tiranë, Janar 2017. Publikimi mund të lexohet në lidhjen: <http://cdinstitute.eu/web/wpcontent/uploads/2017/02/Monitoring-theBerlin-Process-From-Paris-to-Trieste.pdf>

Hackaj, A., Madhi, G., & Hackaj, K. (2015). “*Shqipëria në Procesin e Berlinit Arritjet aktuale dhe sfidat e Samitit të Parisit*”. Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim/ ShtetiWeb, Tiranë 2015. Publikimi mund të

lexohen në lidhjen: <http://cdinstitute.eu/web/wp-content/uploads/2016/02/ANGLISHT.pdf>

INSTAT (2015), “*Youth in Albania: Challenges in changing times*”. Tiranë, 2015.

INSTAT (2015), *Tregu i Punës*. Publikimi mund të lexohet në lidhjen: http://www.instat.gov.al/media/1703/tregu_i_punes_2015.pdf

INSTAT <http://www.instat.gov.al/>

Komisioni Evropian (2018), “*Një perspektivë e besueshme e zgjerimit në Ballkanin*”. Publikimi mund të lexohet në lidhjen: https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/annex-communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

Komisioni Evropian (2019), *Raporti për Shqipërinë*, COM(2019) 260, Bruksel, 29 Maj. Raporti mund të lexohet në lidhjen: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

Komisioni Evropian, Politikat e Fqinjësisë Evropiane dhe Negociatat e Zgjerimit, Kapitujt e acquis. Për më shumë shiko lidhjen: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (2007), *“Strategjia Kombëtare e Rinisë 2007-2013”*, Tiranë 2007.

SALTO-YOUTH (2016), *“The Europe-Western Balkans Youth Meeting “Connecting Youth Work and Youth Policy, ”*. Publikimi mund të lexohet në lidhjen: <https://www.salto-youth.net/downloads/4-17-3471/Report%20Europe-WB%20Youth%20Meeting.pdf>

Western Balkans Youth Cooperation Platform (WBYCP) (2019), *“Western Balkans through Youth Lenses”*. Publikimi mund të lexohet në lidhjen: http://www.connecting-youth.org/documents/2019_WBYCP%20Policy%20Brief_web.pdf

Rreth projektit - CONNECT

Projekti “Një qasje sektoriale për kontributin e shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian - CONNECT” është iniciativa më e re e udhëhequr nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim e cila fokusohet në integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ky projekt synon të inkurajojë përfshirjen e shoqërisë civile dhe sidomos të rinjve në dialogun e politikbërjes, si dhe ndërgjegjësimin e përgjithshëm mbi kontributin tyre të vazhdueshëm në procesin e integrimit evropian, veçanërisht gjatë negociatave për anëtarësim.

Projekti CONNECT mbështetet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë/ CFCU dhe është duke u zbatuar në partneritet me Fondacionin Friedrich Ebert (Tiranë) dhe Qendrën Savremene Politike / European Western Balkans (Beograd).

Kontakt:

✉ Email: info@connectwitheu.al

🌐 www.connectwitheu.al

Rreth Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI)

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) është një organizatë me zyrë në Tiranë e pavarur, jo-fitimprurëse dhe jo-qeveritare, e themeluar në vitin 2000 dhe e fokusuar në analizën dhe kontributin në politikat publike në rang kombëtar dhe rajonal. Misioni i CDI është të kontribuojë në cilësinë e politikbërjes me hulumtim të hapur dhe bazuar në evidenca, advokim dhe debat. Nëpërmjet hulumtimit, publikimeve, eventeve dhe mediave sociale, CDI promovon një hapësirë unike debati për të gjithë ata që janë të interesuar në përmirësimin e cilësinë së politikbërjes.

Kontakt:

📍 Adresa: Rr. Milto Tutulani,

Nd.6, Hyrja 8/3 & 4

1019, Tiranë, Shqipëri

☎ Tel/Fax: +355 4 2203054

✉ E-mail: info@cdinstitute.eu

🌐 www.cdinstitute.eu

*Shënim: Ky dokument është realizuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.